



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Psikologji

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigje e saktë	B	D	C	A	B	C	B	C	B	D

1. B) zhvillimor;
2. D) nga sistemi nervor qendror dhe sistemi nervor periferik. ;
3. C) përbërësi kognitiv;
4. A) kinestezisë;
5. B) sensoro/motor;
6. C) vetëm nga superego;
7. B) amnezi pas hipnotike;
8. C) përqëndrimi të vemendjes, kufizim i stimujve të jashtëm dhe qetësi e brendshme;
9. B) shpjegimit psikoanalitik;
10. D) nuk vishen mirë;

Pyetjet me zhvillim

11. 3 pikë

- a) realizohet shpejt;
- b) mbledh një informacion të madh për shumë njerëz në një kohë shumë të shkurtër;
- c) lejon të bëhen shpesh parashikime të sakta për prirjet e dukurive që studiohen.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan tre përparësi;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy përparësi;**1 pikë** Nëse shkruan një përparësi;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.12. **3 pikë**

a) forca për sukses- sesa fort e dëshiron njeriu atë sukses;

b) pritshmëria që njeriu ka për suksesin që synon;

c) forca shpërblyese e suksesit ose dështimit të mundshëm.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan tre faktorë;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy faktorë;**1 pikë** Nëse shkruan një faktor;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.13. **3 pikë**

a) kur maskojmë ne nuk lejojmë që të shprehet emocioni i vërtetë. Kështu veprohet kur dikujt i bëjnë një dhuratë pa vend dhe ai duke u përpjekur të përmbajë veten për të mos treguar shokimin (mospëlqimin) buzëqesh duke falenderuar.

b) ekzagjerimi i shprehjes së emocionit. P.sh kur dikush tregon një anekdotë vë re se të tjerët qeshin më shumë se vetë ai, atëherë dhe ai vendos të qeshë si ata duke bërë një të qeshur më të madhe se ajo që ndien.

c) përpjekja për të mos treguar shprehjen emocionale./Njihet si reagimi i fytyrës së pokeristit.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan thelbin e të tria mënyrave të kërkuara;**2 pikë** Nëse shkruan thelbin e dy mënyrave të kërkuara;**OSE****1 pikë** Nëse shkruan thelbin e një mënyre të kërkuar;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.14. **2 pikë**

- ankthi është një reagim emocional kompleks që përbëhet nga frikëra të paspecifikuara/ndërsa frika është emocioni i rrezikut nga diçka.

- kur kemi ankth ne nuk e dimë nga se rrezikohemi/ ndërsa kur kemi frikë e dimë.

Nxënësi fiton:**2 pikë** Nëse shkruan nga një tipar për secilën dukuri në mënyrë krahasuese;**OSE****1 pikë** Nëse shkruan një tipar për njërën dukuri në mënyrë krahasuese;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.15. **3 pikë**

a) stadi i parë: sjellja morale e fëmijës përcaktohet nga frika që ai ka nga pasojat e sjelljes së kryer. Nxënësi i shkollës fillore i përket këtij stadi. Ai i merr vendimet duke kufizuar sjelljet nga frika e ndëshkimit ose kryejnë sjellje nga të cilat marrin përfitime si dhe kryejnë sjellje që miratohen nga të tjerët dhe i lejon autoriteti.

b) stadi i dytë: sjellja morale e nxënësit përcaktohet nga fakti se çfarë presin të tjerët nga njeriu.

Adoleshentët janë në këtë stad të zhvillimit moral dhe ata quajnë sjellje morale ato që pëlqehen dhe miratohen nga të tjerët dhe nga ligji.

c) stadi i tretë: sjellja e nxënësit përcaktohet nga parimet personale të tij. Adoleshentët kanë sjellje që zhvillohen në këtë stad. Ata quajnë morale disa sjellje që i konsiderojnë vetë si të tilla.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan çfarë ndodh në të tre stadet;

OSE

2 pikë Nëse shkruan çfarë ndodh në dy stade;

1 pikë Nëse shkruan çfarë ndodh në një stad;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

16. 3 pikë

- i rrezikon njerëzit të përdoren dhe të abuzohen nga të tjerët fizikisht, verbalisht, emocionalisht.
- shkatërron besimin në vete dhe pengon që njeriu të marrë fatin e vet në dorë.
- shkatërron qetësinë e brendshme dhe na pengon që ta pranojmë veten ashtu si jemi.
- ushqen impulsione tonë të lëndimit tonë të të tjerëve përmes neglizhimit, gjuhës abusive, ose ndëshkimit fizik ashtu siç të tjerët kanë bërë me ne.
- i çon shumë njerëz drejt alkoolizmit, varësi ndaj drogës dhe në sjellje të tjera shkatërruese ndaj vetes.
- i bën njerëzit të ndiejnë frikë, dobësi dhe rrezik të vazhdueshëm.
- i bën njerëzit që të ndihen të pafuqishëm, pa kontroll mbi jetën e tyre.
- ushqen emocione shkatërruese si ankthi, frika etj., që çojnë në sëmundje si kanceri, hipertensioni, sëmundje zemre etj.
- i shtyn disa njerëz të besojnë se zoti nuk i do dhe se ata janë pa vlera.
- shtyn në vetëvrasje.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre anë negative;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy anë negative;

1 pikë Nëse shkruan një anë negative;

OSE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

17. 3 pikë

- a) 5 operacione mendore/veprimet që kryejmë kur mendojmë;
- b) 4 përmbajtje/ fjalët;
- c) 6 produkte/ idetë në të cilat përfundojmë pasi pasi kemi menduar;

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre aftësi;

2 pikë Nëse shkruan dy aftësi;

OSE

1 pikë Nëse shkruan një aftësi;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

18. 4 pikë

- a)
 - ndihmojnë për të organizuar informacionin në një mënyrë që ta mbani mend lehtë;
 - ndihmojnë më shumë kujtesën sesa përsëritja e thjeshtë;
 - shumica e tyre kanë në themel imagjinatën;
 - imazhet pamore janë më të lehta për t'u mbajtur mend;
 - duke e kthyer informacionin në imazhe pamore, mbahet mend më lehtë.
- b)
 - ka të bëjë me lidhjen e fakteve, ideve etj që doni të kujtoni;
 - Hapi i parë: mendoni për vende që janë shumë të njohura për ju;
 - Hapi i dytë: lidheni secilin nga faktet, idetë, objektet etj., që ju doni të mbani mend me një nga këto vende.
- c) bashkoni shkronjat ose rrokjet e para të fjalëve dhe formoni një fjalë tjetër e cila ju kujton radhën e fjalëve që doni të mbani mend.
- d) klasifikimi i informacionit sipas kuptimit që ka, sipas llojit, klasës etj.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan thelbin e katër mënyrave të kërkuara;

OSE

3 pikë Nëse shkruan thelbin e tre prej mënyrave të kërkuara;

2 pikë Nëse shkruan thelbin e dy mënyrave të kërkuara;

OSE

1 pikë Nëse shkruan thelbin e një mënyre të kërkuar;

OSE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

19. **2 pikë**

a) Ajo që thuhet është e rëndësishme si për mendimet ashtu dhe për ndjenjat/Prandaj ajo që thuhet ndërtohet në një mënyrë që të ketë ndikim dhe tek mendimet dhe tek ndjenjat./

Sa më shumë të përsëritet një mesazh, aq më shumë ka mundësi të shërbejë si element formues i një qëndrimi.

b) kur auditori është i informuar, komunikuesi duhet të japë e të marrë me të/ Kur auditori është i painformuar komunikuesi i transmeton atij atë që ka për t'i thënë.

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse shkruan rrugën e zgjedhjes dhe njohjen e auditorit;

OSE

1 pikë Nëse shkruan rrugën e zgjedhjes;

OSE Nëse shkruan njohjen e auditorit;

OSE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

20. **4 pikë**

a) i shpjegojnë çrregullimet e sjelljes me ndikimin që ushtrojnë mbi sjelljet dhe emocionet e individit proceset e tij kognitive, mendore;

b) kognitivistët mendojnë se ajo që ne mendojmë ushtron një ndikim të fuqishëm në mënyrën se si ne sillemi dhe ndjehemi;

c) ata supozojnë se kur dikujt i ndryshojmë mënyrën se si ai mendon i kemi ndryshuar automatikisht edhe se si do të ndihet dhe do të sillet;

d) kurimi orientohet drejt ndryshimit të mënyrës se si ky klient mendon për këtë gjë.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan katër elemente nga shpjegimi i kërkuar;

OSE

3 pikë Nëse shkruan tre elemente nga shpjegimi i kërkuar;

2 pikë Nëse shkruan dy elemente nga shpjegimi i kërkuar;

1 pikë Nëse shkruan një elemente nga shpjegimi i kërkuar;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.